

Ministrja Nagavci fton të gjithë akterët të kontribuojnë për zhvillimin në fëmijërinë e hershme

Me Ligjin e ri për Edukimin në Fëmijërinë e hershme, i cili së shpejti do të dalë në dëgjim publik, është paraparë që edukimi parafillor të bëhet i obligueshëm nga viti 2023-2024. Kështu ka thënë ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, në Panelin e diskutimit ku është prezantuar Dokumenti pozicionues lidhur me qendrat e kujdesit për fëmijë në Kosovë, i përgatitur nga Instituti Riinvest.

Ministrja Nagavci tha se prioritet i Qeverisë së Kosovës është edukimi në fëmijërinë e hershme, ku synohet përfshirja në edukim cilësor për çdo fëmijë si një e drejtë e garantuar, pa dallim gjinie, etnie, prejardhje apo besimi fetar.

Pasi që theksoi rëndësinë e zhvillimit në fëmijërinë e hershme, ministrja Nagavci përmendi përfshirjen e ulët të fëmijëve në edukimin e hershëm për shkak të numrit të pamjaftueshëm të institucioneve, mungesës së investimeve, mungesës së resurseve njerëzore, si dhe vetëdijesimit.

Përveç hapat të rëndësishëm në përmirësimin e infrastrukturës ligjore që është duke u punuar, ministrja Nagavci theksoi se kjo çështje është adresuar me prioritet edhe në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2022-2027, i cili është në përfundim.

Në bazën ligjore dhe strategjike për këtë nivel të edukimit janë paraparë 5 milion euro vetëm për vitin 2022, ndërsa u është kushtuar kujdes i veçantë fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe fëmijëve nga grupe të marginalizuara.

Por, Ministrja tha se një vëmendje të veçantë do të kenë fëmijët e zonave rurale, ku përfshirja është tejet e ulët, në mënyrë që të zvogëlohet hendeku me fëmijët e zonave urbane, ku pjesëmarrja në edukimin e hershëm është më e lartë.

Ministrja Nagavci theksoi se bashkëpunimi me drejtoritë e arsimit nëpër komuna, shoqërinë civile, ekspertët e fushave si dhe komunitetin në përgjithësi, do të ndihmojë në realizimin e synimit për të ofruar gjithëpërfshirje dhe cilësi në edukimin në fëmijërinë e hershme, i cili ka përfitime të shumfishta për shoqërinë.

Rëndësinë e investimit në edukimin në fëmijërinë e hershme e theksuan në fjalën e tyre edhe pjesëmarrësit tjerë në panel, nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Alban Zogaj, Majlinda Zhitia Gjellaj nga Fakulteti i Edukimit Alban Hashani dhe Tringë Shkodra nga Riinvest, Nora Latifi nga Instituti GAP, si dhe pjesëmarrësit tjerë në diskutim.